



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.192/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyndi Haziri kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Fejzullah Rexhepi anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtarës së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Euroatlantike e Kosovës (PEK), me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

#### VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.192/2019 e datës 02.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, kundër Subjektit politik Partia Euroatlantike e Kosovës (PEK), për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore.

#### A r s y e t i m

Me datën 02.10.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 02 Tetor 2019 rreth orës 10:50, kane vërejtur se kandidati për kryeministër i Partisë Euroatlantike të Kosovës (PEK), Milaim Zeka, në rrjetin e tij social në Facebook, me datë 1 Tetor 2019, ka shpërndarë disa fotografi me fëmijë duke shënuar “ Intervista e Vitiit”. Ku me anë të këtyre fotografive paraqitësi i ankesës vlerëson se kandidati për kryeministër i partisë PEK, është munduar që të përfitojë vota emocionale nga ky rast.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me Rregulloren 13/2013, e plotësuar me rregulloren 20/2019, nen 5 paragrafi 3 pikën D.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi të printuara.

Në përgjigjen në ankesë të datës 02.10.2019, subjekti politik PEK, theksohet z. Zeka ka qenë i ftuar në intervistë në një TV privat, ku është intervistuar nga fëmijët në emision i cili nuk ka të bëjë fare me fushatë. Me tutje në përgjigje në ankesë theksohet se subjekti politik PEK, nuk ka zhvilluar fushatë fare, në mungesë buxheti, dhe se postimi sipas tyre është térhequr.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

#### Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, vendimet e tij i bazon në dëshmi qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së, e që në rastin konkret fotografitë me fëmijë të ofruara nga ankuesi

të cilat janë shpërndarë në rrjetin social Facebook, për panelin është e paqartë dhe nuk është bindëse për të vendosur ndryshe në këtë rast, ngase prej fotografive të cilat gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet se fëmijët janë duke e promovuar subjektin politik PEK, dhe nuk vërehet se të njëjtë kanë përdorur ndonjë shenjë të këtij subjekti, dhe njehërit nuk kemi CD e intervistës së bërë sipas pretendimeve-përshkrimeve të ankuesit siç pretendohet në ankesë, se ka bërë fushatë me fëmijë. Andaj paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet-përshkrimet se është thyer Kodi i Mirësjelljes nga subjekti politik PEK. Më këtë rast paneli konsideron se parashtuesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli, të merr vendim në favor të saj.

Andaj, pretendimet ankimore të ankuesit së është bërë shkelja e Rregullës Zgjedhore 20/2019, për fushatën e zgjedhjeve, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 pika d), nga ana e subjektit politik PEK, janë të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të rregullës zgjedhore 02/2019, për ndryshimin dhe plotësimin e rregullës zgjedhore Nr. 13/2013.

Nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, nen 117 paragrafi 3 nen 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 8 paragrafi 4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.192/2019 më datën 05.10.2019



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.